



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



MEMORANDUM SHPJEGUES

Për Projekt-Planin Komunal për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Kamenicës për periudhën 2026-2029

1. Hyrje

Ky Memorandum Shpjegues është hartuar për të sqaruar përmbajtjen, qëllimin dhe rëndësinë e Projekt-Planit Komunal për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Kamenicës për periudhën 2026-2029.

Hartimi i këtij plani mbështetet në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Strategjinë Shtetërore për Migrim, Rregulloren për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Rregulloren për Integrimin e të Huajve në Republikën e Kosovës. Dokumenti është përgatitur në bashkëpunim ndërmjet institucioneve komunale, Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, ministrive përkatëse dhe partnerëve vendorë e ndërkombëtarë.

2. Qëllimi i planit

Qëllimi kryesor i këtij plani është krijimi i një sistemi të qëndrueshëm dhe funksional për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Kamenicës, duke siguruar qasje të barabartë në shërbime publike, mundësi ekonomike, arsim, mbrojtje sociale dhe pjesëmarrje aktive në jetën shoqërore.

Planin synon që personat e kthyer dhe të huajt të përfshihen plotësisht në jetën ekonomike dhe sociale të komunës, duke parandaluar marginalizimin dhe migrimin e përsëritur.

3. Përmbajtja e planit

Dokumenti përcakton objektiva strategjike, aktivitete konkrete, institucione përgjegjëse, afate kohore, indikatorë matës dhe mekanizma monitorimi për realizimin e procesit të riintegritit dhe integritit.

Objektivat kryesorë të planit përfshijnë:

- Përmirësimin e sistemit të riintegritit dhe integritit përmes identifikimit të nevojave individuale dhe ofrimit të shërbimeve sipas planeve individuale.
- Fuqizimin e sistemit të referimit dhe koordinimit ndërinstitucional për trajtimin efikas të rasteve.

- Mbështetjen e integrimit ekonomik përmes punësimit, vetëpunësimit, aftësimin profesional dhe përkrahjes në bujqësi.
- Përmirësimin e mbrojtjes sociale dhe strehimit për personat e riatdhesuar dhe të huajt në nevojë.
- Përfshirjen e fëmijëve të riatdhesuar dhe të huaj në sistemin arsimor, duke siguruar mbështetje gjuhësore dhe pedagogjike sipas nevojës.
- Nxitjen e integrimit social përmes aktiviteteve kulturore, rekreative dhe informuese.
- Forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve lokale, organizatave të shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtarë.
- Koordinimin e ndihmës financiare dhe teknike nga donatorët dhe projektet zhvillimore.
- Ngritjen e kapaciteteve profesionale të stafit të angazhuar në procesin e riintegritimit dhe integrimit.

4. Përfitimet e pritshme

Zbatimi i këtij plani pritet të kontribuojë në:

- Përmirësimin e cilësisë së jetës së personave të riatdhesuar dhe të huajve.
- Rritjen e shkallës së punësimit dhe vetëpunësimit.
- Përfshirjen më të madhe të fëmijëve në sistemin arsimor.
- Përmirësimin e qasjes në shërbime sociale, shëndetësore dhe administrative.
- Forcimin e kohezionit social dhe integrimit në komunitet.
- Rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe efikasitetit në ofrimin e shërbimeve.

5. Implikimet financiare

Aktivitetet e parapara në plan do të financohen përmes burimeve buxhetore komunale, programeve qeveritare, fondeve të ministrive përkatëse, si dhe përmes mbështetjes së organizatave vendore dhe ndërkombëtare që veprojnë në fushën e migrimit, riintegritimit dhe integrimit.

6. Përfundim

Projekt-Plani Komunal për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve 2026-2029 paraqet një instrument të rëndësishëm për avancimin e politikave lokale të integrimit dhe përmirësimit të obligimeve institucionale në këtë fushë. Zbatimi i tij do të mundësojë ofrimin e shërbimeve më efikase dhe krijimin e kushteve të favorshme për një integrim të qëndrueshëm ekonomik, social dhe arsimor të personave të riatdhesuar dhe të huajve në Komunën e Kamenicës.